

Bashkia Berat  
Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Kjo drejtori ka kompetenca administrative,zbatuese,ekzekutuese dhe planifikuese për sferën e realizimit të veprimtarisë së vet dhe raporton mbi zbatimin ligjor para Kryetarit. Drejtoria funksionon me 15 punonjës mbi këtë strukturë:

## **QËLLIMI I DREJTORISË**

Të orientojë punën e stafit të drejtorisë drejt identifikimit,trajtimit, për të qënë sa më pranë të gjitha shtresave në nevojë në varfëri ekstreme, personave me aftësi të kufizuara,grave k/familjare,fëmijve të pambrojtur,personave të moshës së tretë,jetimëve,romëve,egjyptianëve me synim zbutjen e problemeve të tyre nëpërmjet bashkëpunimeve me Donatorë të huaj si dhe me OJF që veprojnë në fushën e Shërbimeve Sociale.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kompetenca administrative, zbatuese, ekzekutuese dhe planifikuese për sferën e realizimit të veprimtarisë së vet dhe raporton mbi zbatimin ligjor para Kryetarit.

## **DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL PERBËHET:**

1. Drejtroi i Shërbimit Social
2. Përgjegjshi i ndihmës ekonomi dhe pagesës së aftësisë të kufizuar
3. Përgjegjësi i shërbimeve shoqrore
4. Administratorët e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë të kufizuar (8 punonjës)
5. Punonjësi i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve
6. Kordinatori për dhunën dhe barazin gjinore
7. Punonjëse këshillimore pranë Qendrës Komunitare (2 punonjëse)
8. Psikolge pranë Qendrës Komunitare

## **OBJEKTIVAT E DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL**

1. Orientimi i punes drejt identifikimit,trajtimit edhe permes adresimit te problemeve,te familjeve ne kushtet e varferise ekstreme,grave ne nevoje,femijve te pambrojtur,personave te moshes se trete,jetimeve,romeve,egjyptianeve me synim zbutjen e problemeve te tyre dhe fuqizimin e kategorive te siperpermendura.

2. Te percaktoje sipas ligjit ndihmen dhe sherbimet shoqerore per individet dhe grupet ne nevojte,te cilet nuk mund te sigurojne plotesimin e nevojave baze jetike,zhvillimin e aftesive dhe te mundesive personale per ruajtjen e integritetit per shkak te aftesive te kufizuara ekonomike,fizike,psikologjike e shoqerore.
3. Partneritet dhe bashkepunim konkret me Institucionet e OJF me qellim gjithte perfshirjen e komuniteteve.
4. Hartimi dhe aplikimi i projekteve te ndryshme me Organizatat Nderkombetare,per te sjelle sa me shume sherbime per Komunitetin tone.
5. Implemetimi i planit social
6. Parandalimin dhe reduktimin e dhunes ne familje ne te gjitha format e saj,me ane te masave te pershtateshme ligjore.
7. Mbrojtje te vecante te te drejtave te femijve nepermjet marjes se masave per ti siguruar ushtrimin e te drejtave te tyre brenda kuadrit ligjor,bashkepunimit midis strukturave dhe autoriteteve qendrore e lokale,.